

Përgjegjës në Sektorin e Inovacionit, në Drejtorinë e Kërkimit, Zhvillimit dhe Inovacionit, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Përgjegjës në Sektorin e Inovacionit, në Drejtorinë e Kërkimit, Zhvillimit dhe Inovacionit, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Zhvillon dhe promovon produkte inovative të bazuara tek produktet e përfutuara nga drejtoritë e tjera teknike.
2. Bashkëpunon në fushën e inovacionit me akademinë dhe biznesin.
3. Raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë e sektorit pranë Drejtorit të Drejtorisë për të gjitha produktet inovative të ideuara apo të realizuara.
4. Bashkëpunon për përgatitjen e draft-akteve nënligjore që lidhen me informacionin gjeohapësinor sipas sektorëve përkatës.
5. Bashkëpunon për rritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në proceset që lidhen me kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin, si dhe për përhapjen e informacionit që lidhet me grupet e interesit dhe publikun.
6. Mbështet Drejtorin e Drejtorisë në organizimin e aktiviteteve promovuese të të gjitha produkteve inovative dhe jo vetëm të ASIG.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

- Të këtë mbaruar studimet e larta e të zotërojë një diplomë të nivelit "Master shkencor", profili Shkenca Ekonomike.
- Të këtë të paktën 3 (tre) vite eksperiencë pune në profesion.
- Kualifikime përkatëse në fushat e Kërkimit, Marketingut/Komunikimit, Sipërmarrjes apo të ngjashme.
- Të këtë marrë pjesë apo të këtë njohuri për krijimin e platformave inovative.
- Të këtë marrë pjesë apo kontribuar në hartim politikash, strategjish dhe implementim të tyre.
- Të këtë aftësi të mira drejtimi, komunikimi, negocimi, gjykim e iniciative për t'u marrë me probleme komplekse.

- Të njohë mirë gjuhën angleze, edhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.
- Të njohë programet kompjuterike.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (III-a/1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 20.08.2023, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nd. 2, H.3, Kati 2, Tiranë ose në adresën e e-mailit info@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t'u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.